



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268142; 22268141

Nr. 1530 Prot.

Tiranë, më 27.07.2017

V E N D I M

Nr. 175, datë 27.07.2017

“Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 124, datë 18.05.2017, ‘Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Prefektin e Qarkut Berat dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë’”

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14 , të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 124, datë 18.05.2017, të Komisionerit.

VENDOSA:

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 124, datë 18.05.2017, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, Prefektura e Qarkut Berat dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.
2. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:
 1. **Enkelejda Hebibasi** Drejtor i Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
 2. **Stela Ndoka** Specialist, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë
 3. **Helga Peti** Specialist, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

3. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt, në datën **26.09.2017**.
4. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Relacioni duhet të përpilohet deri në datën **03.10.2017**. Më pas do t'i paraqitet për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohet vendimi për përmbylljen e procesit, brenda datës **06.10.2017**.
5. Vendimi përfundimtar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e verifikimit do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur, Prefektit të Qarkut Berat, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
6. Ngarkohet Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrë masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.
7. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse që të sigurojë mbështetjen e grupit të verifikimit me logjistikë, për vijimin normal të procesit, në përputhje me programin e miratuar.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268142; 22268141

Nr. 1530/1 Prot.

Tiranë, 27.07.2017

M I R A T O H E T

Pranvera STRAKOSHA

KOMISIONER

PROGRAM VERIFIKIMI

"Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 124, datë 18/05/2017, 'Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Berat dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar ligjshmërinë'".

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** Prefektura e Qarkut Berat
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i Vendimit paralajmërues Nr. 124, datë 18.05.2017, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefekturës së Qarkut Berat dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14, i ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Rregullorja "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.
- 4. Afati i verifikimit:** Verifikimi do të fillojë në institucion në datën **26.09.2017**
- 5. Procedura që do të ndiqet:** Për parregullsitë e konstatuara do të mbahen aktet e konstatimit, procesverbal administrativ, të cilët do të nënshkruhen nga grupi i verifikimit dhe personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.
- 6. Grupi i punës:** **1. Enkelejda Hebibasi** Drejtor i Çështjeve

Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

2. Stela Ndoka

Specialist, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

3. Helga Peti

Specialist, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

7. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:

Në përfundim të procesit të verifikimit do të përgatitet relacioni përkatës nga Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbalet e mbajtuara në subjektin e verifikuar si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do të dërgohet institucionit (*n.q.s vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar*).

DREJTIMET E VERIFIKIMIT

I. Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin Nr. 124, datë 18.05.2017, *"Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin, e Prefekturës së Qarkut Berat dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë"*, nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmëruar, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:

1. *Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Berat, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.*
2. *Për të rregulluar situatën në lidhje me pozicionin e punës "Sekretar i Përgjithshëm", në institucionin e prefektit të qarkut, me qëllim sqarimin e rolit të tij në skemën e administrimit të shërbimit civil, njësia përgjegjëse (DAP), duhet të përcaktojë kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet ky pozicion, ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit Nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të vendimit Nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar. Ky proces duhet të gjejë pasqyrim edhe në përshkrimin e punës për pozicionin "Sekretar i Përgjithshëm", në institucionin e prefektit.*

3. Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si organizma që menaxhojnë burimet njerëzore të institucionit, të përfundojnë hartimin e përshkrimeve të reja të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin Nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, lidhjeve pjesë e këtij vendimi dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.

Institucioni i mbikëqyrur t’i kërkojë Departamentit të Administratës Publike, që të japë zyrtarisht konfirmimin e tij, lidhur me përshkrimet e punës, nëse ato janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit Nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), përshkrimet e punës t’i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të vijuar procesin me nënshkrimin e tyre në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të vendimit Nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

4. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, për punonjësit ***** dhe *****; duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve administrative të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit si dhe akteve të tjera që kanë dalë në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Berat, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, pasi pozicionet e gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën e tyre, nuk janë pjesë e shërbimit civil, por janë funksione të deleguara.

Për ndreqjen e këtyre parregullsive, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të veprojë si më poshtë:

- Të anulojë aktin administrativ Nr. 1246/9, datë 14.08.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit” për punonjësen ***** me të cilën është deklaruar “Nëpunës civil”, si dhe Vendimin Nr. 514/2 prot., datë 12.04.2016, për transferimin e kësaj punonjëseje, nga “Përgjegjëse e zyrës së gjendjes civile” në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe funksioneve të Deleguara”, i cili është një pozicion pune që përfshihet në shërbimin civil. Si i tillë, ky pozicion mund të plotësohet nëpërmjet transferimit, vetëm nga nëpunës brenda shërbimit civil.

Njësia përgjegjëse, këtë pozicion pune duhet ta shpallë si vend të lirë pune dhe duhet të nisë procedurën e plotësimit të tij sipas kërkesave të ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

- *Të anulojë aktin administrativ Nr. 1246/19, datë 14.08.2014, “Akti i deklaramit të statusit të punësimit”, për punonjësen *****, me të cilën është deklaruar “Nëpunës civil”;*
- *Të anulojë aktin administrativ Nr. 1246/10, datë 14.08.2014, “Akti i deklaramit të statusit të punësimit”, për punonjësin *****, me të cilën është deklaruar “Nëpunës civil”.*

5. *Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e institucionit, në aktet e lirimit të nëpunësve:*

- ✓ *****, *liruar me aktin Nr. 40 datë 25.04.2016;*
- ✓ *****, *liruar me aktin Nr. 41 datë 25.04.2016;*
- ✓ *****, *liruar me aktin Nr. 39 datë 25.04.2016,*

të cilëve u është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit, të shënojë në mënyrë të shprehur të drejtat që përfitojnë këta nëpunës sipas përcaktimeve të pikës 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë në këtë rast, aktet respektive të lirimit nga detyra, duhet të plotësohen me njohjen e të drejtave të sipërpërmendura, si dhe këto akte të plotësuara, t’u njoftohen të interesuarve.

6. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

- II. Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.
1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
 2. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të verifikimit.

**DREJTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE
DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Enkelejda HEBIBASI